

# Garantimi i cilësisë në informacionin dhe këshillimin e të rinjve

Këshilla praktike për zbatimin e Kartës Evropiane të  
Informacionit për Rininë



**Kryeredaktore:**

Eva Reina

**Redaktorë:**

Imre Simon, Beatriz Terreros

**Kontribues:**

Patrick Burke, Youth Work Ireland, ERYICA GB Member

Gareth Gibson, Youth Work Ireland – Donegal Youth Services

Sophie Girardeau, CIDJ, France

Maria José Monzó, IBOVE, Spain

Chrysoula Karanthisi, Agence Nationale pour l'Information des Jeunes, Luxembourg

Eva Reina, ERYICA, Luxembourg

Imre Simon, ERYICA, Luxembourg

Claire Conlon, CIDJ France

**Korrektura letrare e origjinalit:**

Jessica Walker

**Faqosja dhe ilustrimet e origjinalit:**

Marina de los Ángeles Ferragut <https://marinadelosangeles.pb.gallery/>



**E drejta e autorit:** ERYICA a.s.b.l.

Creative Commons CC-Attribution-NonCommercial-NoDerivatives 4.0 International 2019

Ky botim është krijuar me mbështetjen e Këshillit të Evropës.



**Botuar në bazë të marrëveshjes së partneritetit midis Këshillit të Evropës dhe Agjencisë Evropiane të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë ERYICA.**

*Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Këshillit të Evropës.*

## I dashur lexues,

Me zgjedhjen time si Presidente e ERICA-s, në prill 2016, pyeta veten se cilat ishin çështjet kryesore për të cilat doja të kontribuoja me përvojën dhe njohuritë e mia. Njëra, kyçe, qe **Karta Evropiane e Informacionit për Rininë**. Unë e kam parë gjithmonë rëndësinë dhe rolin e saj të madh si një mjet të fuqishëm për promovimin e informacionit dhe këshillimit të të rinjve. Kështu, vërtetë që u kënaqa me vendimin e anëtarësisë tonë e cila vendosi të themelojë një grup pune për rishqyrtimin e Kartës.

E përfshirë si në përditësimin e mëparshëm të Kartës në 2004, ashtu edhe në krijimin e Parimeve për informacionin e Rinisë Online në 2009, isha i bindur se këto dy dokumente qenë vërtetë të nevojshme në atë kohë. Tani që shërbimet online dhe mjediset dixhitale janë integruar plotësisht në punën tonë të përditshme, është sfiduese të justifikojmë ekzistencën e dy dokumenteve. Në të vërtetë, jeta dhe sjellja jonë në internet nuk janë më të ndara nga realiteti ynë jashtë internetit.

Kur filluam procesin e rishqyrtimit, u gëzova tek shihja se sa të rëndësishme dhe të përditësuara ishin ende të gjitha parimet! Nuk na mungonte asgjë thelbësore, por kishte ardhur **koha për të rregulluar mesazhin dhe udhëzimet tona**. Kjo na dha edhe një mundësi të shkëlqyer për të diskutuar dhe për t'i bërë vetes disa pyetje:

- A jemi të gjithë ende të njëmendjeje në lidhje me informacionin dhe këshillimin për të rinjtë?
- Si e shikon Karta botën dhe jetën e të rinjve sot dhe në të ardhmen?
- Si i trajton ajo nevojat e profesionistëve, shërbimet cilësore të për Informimin e të Rinjve, si dhe strukturat kombëtare apo vendore?
- A e mbështesin njëra-tjetrën Karta dhe Strategjia e re e ERYICA-s?
- A duhet të përdorim një gjuhë dhe strukturë më të qartë në këtë dokument?

Karta synon të sigurojë **udhëzime për punën etike të informacionit dhe këshillimit ndaj të rinjve**. Kjo është një "shtyllë kurrizore" për krijimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit për të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Ajo përcakton standardet minimale profesionale dhe parimet e cilësisë për punonjësit e informacionit për të rinjtë. Karta është gjithashtu një mjet për avokim dhe lobim!

Kjo broshurë shërben si një **memorandum shpjegues** që lehtëson zbatimin e Kartës dhe i afron parimet e saj me punën e përditshme të shërbimeve tona. Së bashku me mjetin e vetëvlerësimit të cilësisë së ERYICA dhe Etiketën e ardhshme Evropiane të Cilësisë së Informacionit Rinor, ato përbëjnë tre shtyllat cilësore të shpërndarjes së informacionit për të rinjtë në të gjithë Evropën. Unë besoj se kjo broshurë do të kontribuojë në zbatimin e suksesshëm të parimeve të Kartës.



Jaana Fedotoff  
Presidente e ERYICA



# PËRMBAJTJA

## HYRJE

Çfarë është informimi i rinisë?

Çfarë është Karta Evropiane e Informacionit për Rininë?

Qëllimi i këtij udhëzuesi

## KARTA

Preambula e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë

Parimet e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë

## PARIMET E KARTËS – NGA TEORIA NË PRAKTIKË

E pavarur

E aksesueshme

Përfshirëse

Nevojat

E bazuar

Fuqizuese

Me pjesëmarrje

Etike

Profesionale

Proaktive





## Çfarë është informimi i të rinjve?

Shërbimet e informacionit dhe këshillimit për të rinjtë **ofrojnë informacion dhe udhëzim me cilësi të lartë** për të rinjtë dhe i ndihmojnë ata të marrin vendime të informuara për ta jetuar jetën e tyre në mënyrë konstruktive.

### Këto shërbime:

- sigurojnë **informacion të pavarur, të besueshëm dhe gjithëpërfshirës në mënyrë profesionale;**
- japin një pasqyrë të opsioneve dhe mundësive, bazuar në **nevojat** e të rinjve;
- bazohen në **burime pluraliste dhe të verifikuara**, duke përdorur një shumëllojshmëri të gjerë **kanalesh komunikimi** për të qenë të **aksesueshme** për të gjithë të rinjtë;
- ndihmojnë të rinjtë në **trajtimin e mbingarkesës së informacionit** dhe promovon **edukimin e tyre mediatik dhe informativ;**
- siguron që ata janë të vetëdijshëm për të **drejtat** e tyre dhe që janë në gjendje të **vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin** që aksesojnë; dhe
- **fuqizojnë të rinjtë që të marrin vendimet e tyre**, dhe të gjejnë opsionet më të mira të disponueshme për ta.

## Çfarë është Karta Evropiane e Informacionit për Rininë?

Në vitin 1993, Asambleja e Përgjithshme ERYICA-s, miratoi **Kartën Evropiane të Informacionit për Rininë**, e cila që atëherë është kthyer në parimet dhe udhëzimet profesionale referuese për punën informuese dhe këshillimore ndaj të rinjve në mbarë Evropën.

Parimet e Kartës synojnë të zbatohen për të gjitha format e punës së përgjithshme informuese rinore dhe synojnë të garantojnë të drejtën e të rinjve për informim të plotë, të besueshëm dhe të përditësuar. Ato përbëjnë një bazë për **standardet minimale dhe masat** cilësore të zbatueshme për të gjitha vendet si elementë të një qasjeje gjithëpërfshirëse, koherente dhe të koordinuar për ofrimin e informacionit dhe këshillimit për të rinjtë.

Asambleja e Përgjithshme e 29-të e ERYICA, miratoi një version të përditësuar të Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë në 2018.

Më shumë informacion rreth Kartës dhe përkthimet e saj, mund të gjendet në faqen e internetit [eryica.org](http://eryica.org).



### Qëllimi i këtij udhëzuesi është që:

- Të japë një shpjegim më të gjerë për zbatimin e parimeve të Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë;
- Përcaktojë një sërë funksionesh që janë thelbësore për ofrimin e informacionit cilësor për të rinjtë dhe shërbimet e këshillimit;
- Të ofrojë ndihmë se si të planifikohen dhe ngrihen shërbime të reja;
- Mbështetë zhvillimin dhe vlerësimin e mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese të informacionit dhe këshillimit për të rinjtë;
- Të udhëzojë palët e interesuara dhe politikë bërësit e përfshirë në mbështetjen e informimit dhe këshillimit të të rinjve;
- Theksojë rëndësinë e ofrimit dhe dhënies së burimeve të informacionit dhe shërbimeve këshillimore për të rinjtë ndërmjet financuesve dhe politikë bërësve.

### Ky udhëzues nuk:

- Parashkruan një mënyrë të vetme për të dhënë informacion dhe këshillim për të rinjtë.
- Përbën një udhëzues gjithëpërfshirës për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të informacionit për të rinjtë.


Për këtë qëllim, kontrolloni Paketën Fillestare të Informacionit për Rininë dhe Përmbledhjen mbi Strukturat Kombëtare të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë, të dyja të disponueshme në faqen e internetit [eryica.org](http://eryica.org).

- ofron një mjet për sigurimin e cilësisë për shërbimet e informacionit për të rinjtë.

Për këtë qëllim, kontrolloni Menaxhimin e Cilësisë në Informacionin dhe Këshillimin e Rinisë - Një Kornizë e Zhvillimit të Kompetencës në faqen e internetit [eryica.org](http://eryica.org). ERYICA po përgatit gjithashtu një Etiketë Evropiane të Cilësisë për Informacionin Rinor, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës.

- Trajton në hollësi zbatimin e praktikave të mira.

Për këtë qëllim, kontrolloni broshurat e Praktikave të mira të Informimit të Rinisë të ERYICA-s në faqen e internetit [eryica.org](http://eryica.org).



## Karta Evropiane e Informacionit për të Rinjtë

Miraturar në **Cascais (Portugali)** më **27 prill 2018** nga Asambleja e Përgjithshme e 29-të e Agjencisë Evropiane të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë (ERYICA).

### Preambula

Ne jetojmë në shoqëri komplekse, të dixhitalizuara dhe në një botë të ndërlidhur që ofron shumë sfida dhe mundësi. Qasja në informacion dhe aftësia për të analizuar dhe përdorur informacionin është gjithnjë e më e rëndësishme për të rinjtë në Evropë dhe më gjerë. Puna për informimin e rinisë, i ndihmon ata të arrijnë aspiratat e tyre dhe promovon pjesëmarrjen e tyre si anëtarë aktivë të shoqërisë. Informacioni duhet të sigurohet në mënyra që zgjerojnë zgjedhjet në dispozicion të të rinjve dhe që promovojnë autonominë dhe fuqizimin e tyre.

Respekti për demokracinë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, nënkupton të drejtën e të gjithë të rinjve për të pasur akses në informacion të gjithanshëm, objektiv, të kuptueshëm dhe të besueshëm, për të gjitha pyetjet dhe nevojat e tyre. Kjo e drejtë për informacion është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe Liritë Themelore të njeriut, si dhe në Rekomandimet Nr. (90) 7, CM/Rec(2010)8 dhe CM/Rec(2016)7 të Këshillit të Evropës në lidhje me informacionin dhe këshillimin për të rinjtë dhe qasjen e të rinjve tek të drejtat. Kjo e drejtë është edhe baza për veprimtaritë informuese rinore, të ndërmarra nga Bashkimi Evropian.

Puna e përgjithshme informuese për të rinjtë mbulon të gjitha temat me interes për të rinjtë dhe mund të përfshijë një gamë të gjerë veprimtarish: informim, këshillim, mbështetje, stërvitje, trajnim, rrjetëzim dhe referim në shërbime të specializuara për të angazhuar dhe fuqizuar të rinjtë. Këto veprimtari mund të ofrohen nga qendrat e informacionit rinor, ose nëpërmjet shërbimeve të informacionit për të rinjtë në struktura dhe mjedise të tjera. Parimet e kësaj Karte synojnë të zbatohen për të gjitha format e punës së përgjithshme informuese rinore. Ato përbëjnë një bazë për standardet minimale dhe masat cilësore që duhet të vendosen në secilin vend si elementë të një qasjeje gjithëpërfshirëse, me burime, koherente dhe e koordinuar ndaj punës së informimit për të rinjtë, e cila është pjesë integrale e politikave për të rinjtë.



# PËRIMET E KARTËS

## 1. I PAVARUR

- 1.1 Informacioni i dhënë është gjithëpërfshirës, ofron një pasqyrë të opsioneve të ndryshme të disponueshme dhe bazohet në burime pluraliste dhe të verifikuara.
- 1.2 Informacioni i dhënë është i pavarur nga çdo ndikim fetar, politik, ideologjik apo komercial.
- 1.3 Burimet e financimit për informacionin e të rinjve nuk cenojnë zbatimin e asnjë prej parimeve të kësaj Karte.

## 2. Ë QASSHME

- 2.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë, garantojnë qasje të barabartë.
- 2.2 Qendrat dhe shërbimet e informacionit rinor, janë lehtësisht të qasshme, tërheqëse dhe të dukshme për të rinjtë.
- 2.3 Informacioni për të rinjtë është i kuptueshëm për të rinjtë.

## 3. PËRFSHIRËS

- 3.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë janë të hapura për të gjithë të rinjtë pa asnjë formë diskriminimi.
- 3.2 Shërbimet e informacionit për të rinjtë, janë pa pagesë për të gjithë të rinjtë.
- 3.3 Qendrat dhe shërbimet e informacionit për të rinjtë përpiqen të kontaktojnë të gjithë të rinjtë, në mënyra që janë efektive dhe të përshtatshme për grupe dhe nevoja të ndryshme.

## 4. BAZUAR NË NEVOJA

- 4.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë bazohen në nevojat e të rinjve.
- 4.2 Informacioni i disponueshëm mbulon të gjitha temat që kanë rëndësi për të rinjtë.
- 4.3 Çdo përdorues respektohet si individ dhe përgjigja për çdo pyetje është e personalizuar në mënyra që janë efektive dhe të përshtatshme.
- 4.4 Strukturat e informacionit rinor kanë burime të mjaftueshme njerëzore për të garantuar mbështetje dhe shërbime të personalizuar.

## 5. FUQIZIMI

- 5.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë fuqizojnë të rinjtë dhe nxisin autonominë e tyre.
- 5.2 Shërbimet e informacionit për të rinjtë u ofrojnë të rinjve aftësi për shfrytëzimin e medias dhe informacionit për të vepruar në mënyra të sigurt dhe të përgjegjshme.
- 5.3 Shërbimet e informacionit për të rinjtë promovojnë qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive.



## 6. PJESËMARRËS



- 6.1 Të rinjtë marrin pjesë në prodhimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e informacionit rinor, në nivele dhe forma të ndryshme
- 6.2 Shërbimet e informacionit për të rinjtë ofrojnë platforma për veprimtari mes bashkëmoshatarëve.
- 6.3 Të rinjtë inkurajohen të japin komente si pjesë e integruar e zhvillimit të vazhdueshëm të shërbimeve të informacionit për të rinjtë.

## 7. ETIKE

- 7.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë respektojnë të drejtën e të rinjve për privatësi, konfidencialitet dhe anonimitet. Shërbimet e informacionit për të rinjtë ofrojnë një mjedis të sigurt për të rinjtë.
- 7.2 Kriteret për përzgjedhjen e informacionit bëhen publike dhe të kuptueshme. Autori dhe qëllimi i informacionit janë të qarta dhe të dukshme.
- 7.3 I gjithë informacioni i prodhuar ose i shpërndarë është i saktë, i plotë, i përditësuar dhe i verifikuar.

## 8. PROFESSIONAL

- 8.1 Shërbimet e informimit për të rinjtë ofrohen në mënyrë profesionale nga staf i trajnuar.
- 8.2 Punonjësit e informacionit të të rinjve, kanë aftësi për kuptueshmëri mediatike dhe informative.
- 8.3 Shërbimet e informacionit për të rinjtë bashkëpunojnë me palët përkatëse të interesit për të identifikuar nevojat, për të kërkuar sinergji, për të ndarë ekspertizën dhe për ta bërë të dukshme informacionin për të rinjtë.
- 8.4 Punonjësit e informacionit rinor, bashkëpunojnë në nivel vendor, rajonal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar dhe ndajnë praktikatat dhe njohuritë më të mira.
- 8.5 Punonjësit e informacionit për të rinjtë sigurojnë që të rinjtë të kenë njohuri dhe aftësi për të përdorur shërbimet dixhitale të synuara për ta.



## 9. PROAKTIVE

- 9.1 Shërbimet e informacionit për të rinjtë janë inovative në zgjedhjen e strategjive, metodave dhe mjeteve për t'iu afruar të rinjve..
- 9.2 Punonjësit e informacionit të të rinjve janë të vetëdijshëm për zhvillimet e reja, ligjet përkatëse dhe mbajnë veten të informuar për trendet e të rinjve.
- 9.3 Punonjësit e informacionit për të rinjtë, janë lojtarë proaktivë në media dhe në peizazhin e informacionit për të siguruar që informacioni cilësor për të rinjtë të jetë i dukshëm.

Përimet e Kartës  
- Nga teoria në praktikë -



# 1. I PAVARUR

Ofruesit e informacionit për të rinjtë janë të pavarur në ofrimin e informacioneve të plota, si dhe mbeten të paanshëm, pavarësisht nga burimi i financimit.

- Siguron informacion pa ndikim fetar, politik, ideologjik ose tregtar.
- Shmang drejtimin e të riut në procesin e vendimmarrjes që u takon atyre vetë.
- Ballafaqon faktet kundrejt opinioneve.
- Mbështet të rinjtë që të zhvillojnë të menduarit kritik.
- Siguron burime të ndryshme dhe të verifikuara informacioni.

## PRAKTIKË E MIRË

*“Ne sqarojmë opsionet e ndryshme që ka një i ri/e re në një situatë të caktuar. Ne nuk u themi atyre se çfarë të bëjnë. Përkundrazi, ne i inkurajojmë ata të bëjnë zgjedhje të pavarura dhe të mire-menduara, bazuar në informacionin që marrin dhe në vlerat e tyre vetjake. Ne përdorim burime të besueshme dhe u ofrojmë atyre informacion gjithëpërfshirës dhe të paanshëm mbi opsionet e ndryshme të disponueshme. Ne i udhëzojmë të rinjtë drejt informacioneve dhe shërbimeve shtesë të besueshme, në rast se dëshirojnë të marrin më shumë mbështetje”*

Riina Papinaho, Këshilltar informacioni @ [Yl service Nuortelämä.fi](https://www.yl-service.fi), Finlandë

## DËSHMI

*“Unë kam shkuar në Qendrën e Informacionit Rinor për 10 vitet e fundit, më ka sjellë përfitime në aq shumë mënyra sa që ndoshta mund të shkruaj një libër për të! Kur përballem me sfida të ndryshme në jetë, nuk ka vend më të mirë për të shkuar. Punonjësit e informacionit për të rinjtë janë gjithmonë të paanshëm dhe të ndihmojnë të gjesh zgjidhje edhe kur mendon se nuk ka më shpresë*

Jay (24) – Letterkenny, Irlandë



## 2.I QASSHËM

Shërbimet dhe qendrat e informacionit për të rinjtë, janë lehtësisht të aksesueshme, tërheqëse dhe të dukshme për të rinjtë.

- I bën shërbimet të qasshme për të gjithë të rinjtë, duke përfshirë ata me nevoja të veçanta, dhe me më pak mundësi.
- Siguron informacion përmes një sërë kanalesh online dhe offline.
- Përdor një gjuhë miqësore dhe të kuptueshme për të rinjtë dhe përshkrime vizuale.
- Planifikon orare fleksibël të ofrimit të shërbimeve në përputhje me disponueshmërinë e të rinjve.
- Vendos qendra dhe shërbime në vende lehtësisht të aksesueshme, të dukshme dhe miqësore për të rinjtë.
- Krijon një atmosferë të ngrohtë, mikpritëse dhe miqësore për të rinjtë.



### PRAKTIKË E MIRË

*"Qendra e Informacionit Rinor Letterkenny synon të jetë një qendër gjerësisht e aksesueshme në një mënyrë thjesht fizike, si dhe kur bëhet fjalë për faktorin njerëzor. Ekipi ynë prezanton shumëllojshmëri kulturore dhe gjuhësore që i lejon ata të thyejnë shumë barriera në një proces komunikimi me të rinjtë. Për sa i përket orarit të hapjes, YIC operon 5 ditë në javë, duke përfshirë orët e para të mëngjesit dhe mbrëmjet vonë, të cilat na ndihmojnë të arrijmë grupe të ndryshme të rinjsh të moshës 12-30 vjeçare."*

Gareth Gibson, Menaxher i Informacionit Rinor @ Donegal Youth Service, Irlandë

### DËSHMI

WAT WAT bëri një test votimi për zgjedhjet evropiane dhe kombëtare në Belgjikë në maj 2019. Çdo stendë kishte nga një video me një shpjegim të shkurtër dhe argumente pro dhe kundër.

*"I pashë të gjitha videot nga fillimi deri në fund. Ato me të vërtetë më ndihmuan të krijoj mendimin tim. Kam bërë edhe teste të tjera votimi, por pyetje e tyre nuk kanë qenë kurrë kaq të qarta. Në këtë test, të gjitha pyetjet vinin me shpjegimet gjegjëse. Kjo që me të vërtetë gjë e mirë"*

Noa (16) – – Rajoni Antwerp, Belgjikë





## 3. PËRFSHIRËSE

Shërbimet gjithëpërfshirëse të informacionit për të rinjtë nuk diskriminojnë në bazë të racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, gjuhës, fesë, opinioneve politike ose të tjera, origjinës kombëtare, sociale ose gjeografike, aftësisë së kufizuar, lindjes, orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore, ose ndonjë statusi tjetër, siç përcaktohet nga standardet e të drejtave të njeriut.

- Përpiqet të jetë i ndjeshëm ndaj dallimeve dhe gjithëpërfshirës për të gjithë të rinjtë.
- Siguron shërbime informative falas dhe jofitimprurëse për të rinjtë.
- Dëgjon dhe mbështet të rinjtë për të identifikuar nevojat dhe shqetësimet e tyre në kontaktin fillestar dhe i referohet një shërbimi tjetër nëse është e nevojshme.
- Përdor një qasje të shumanshme duke siguruar shërbime plot risi dhe kanale të shpërndarjes të informacionit të përshtatshme për moshën.
- Kontakton të gjithë të rinjtë ku janë, dhe veçanërisht ata me më pak mundësi, ata në rrezik të përjashtimit social dhe të rinjtë e paangazhuar.
- Krijon shkëmbimin e duhur të informacionit dhe ndër-referim me shërbime të tjera të brendshme dhe të jashtme.

### PRAKTIKË E MIRË

*“Rrjeti ynë i Qendrave të Informacionit Rinor (YIC) merr pjesë, mbështet dhe promovon projekte dhe veprime në nivel vendor dhe rajonal që synojnë integrimin e të rinjve nga komunitetet rome. Ne gjithashtu punojmë me emigrantë e refugjatë të rinj, si dhe me të rinj nga prejardhje të tjera të pafavorizuara. Për shembull, YIC në Lisbonë mbështeti edicionin e tretë të trajnimit ndërkombëtar Zërat e Migrantëve të Rinj, i cili synonte ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive se si të zvogëlohej hendeku midis të rinjve me prejardhje migrante dhe institucioneve vendore”.*

Margarida Saco, Punonjës dhe trajnues i informacionit për të rinjtë @ [Instituti Portugez i Sportit dhe Rinisë](#), Portugal

### DËSHMI

*“Unë jetoj në një fshat të vogël në një zonë rurale të Qipros. Qendra Informative Rinore e Agros qe vendi që më dha të gjithë informacionin e nevojshëm. Shërbimet e tyre më ndihmuan në jetën time personale, arsimore dhe profesionale. E njëjta gjë vlen edhe për disa të rinj të tjerë që njoh, të cilët jetojnë në zonën rurale të Troodosit”*

Stelios (24) – Agros, Qipro





## 5.FUQIZIM

**Informacioni për të rinjtë** u mundëson të rinjve të kuptojnë potencialin e tyre të plotë duke i ndihmuar ata të identifikojnë aspiratat e tyre dhe të bëjnë zgjedhje të informuara për jetën.

- Mos ushtroni ndikim te të rinjtë por fuqizojini ata që të marrin vetë vendimet e tyre.
- Sigurimi i mekanizmave mbështetës që të rinjtë të jenë qytetarë aktivë dhe të informuar.
- Lehtësimi i angazhimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivele të ndryshme.
- Promovimi i edukimit për median dhe informacionin, për t'u mundësuar të rinjve të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të zhvillojnë sjellje pozitive në internet.
- Informoni të rinjtë për shërbimet e tjera të ofruara dhe për mundësitë që u hapen.

### PRAKTIKË E MIRË

*“Punonjësit e kualifikuar të informacionit për të rinjtë janë vazhdimisht në dispozicion të të rinjve për t'i inkurajuar ata të gjejnë zgjidhjet e duhura dhe të monitorojnë përparimin e tyre. Vëmendje e veçantë i kushtohet të rinjve emigrantë në kërkimin e informacionit përkatës, veçanërisht në fushën e integritimit kulturor, social dhe politik. Kjo mundëson performancë të qëndrueshme arsimore të fëmijëve dhe adoleshentëve, arsimim të vazhdueshëm, mundësi të mëdha punësimi, kohezion më të madh social, pranim të komuniteteve vendore, dhënie më të mirë informacioni dhe rrjetëzim”.*

Matjaž Medvešek, Punonjës dhe këshilltar për informacionin për të rinjtë @ MISSS, Slloveni.

### DËSHMI

*Dua të falënderoj grupin në Facebook BORSA DE FEINA - INFOJOVE; falë publikimeve **tuaja gjeta punë! Sot filloj dhe jam shumë e lumtur.** Për ata që po vazhdojnë të kërkojnë, mos u dorëzoni! Ka një vend që pret për secilin prej nesh”.*

Laura (27) – Ishujt Balarike, Spanjë



## 6. ME PJESËMARRJE

Shërbimet me pjesëmarrje të informacionit për të rinjtë, motivojnë dhe përfshijnë të rinjtë në hartimin dhe ofrimin e shërbimit.

- U ofrojnë të rinjve mundësi dhe mjete për të marrë pjesë në hartimin dhe ofrimin e shërbimit.
- I përfshijnë të rinjtë në prodhimin, bashkë-projektimin dhe shpërndarjen e informacionit.
- I konsiderojnë të rinjtë si shumëfishues dhe partnerë për të kontaktuar bashkëmoshatarët e tyre.
- Promovojnë mundësitë që të rinjtë të jenë qytetarë aktivë dhe të përfshihen në komunitetet e tyre.
- Inkurajojnë të rinjtë që të japin komente dhe sugjerime rreth mënyrave për të përmirësuar shërbimet e ofruara dhe që të marrin parasysh kontributin e tyre.
- Integrimi i përfaqësuesve të të rinjve dhe komiteteve këshillimore në proceset vendimmarrëse.



### PRAKTIKË E MIRË

“Seria e podkasteve “Teeviit tulevikku” (shenjë për të ardhmen) ofron informacion për të rinjtë e moshës 13-26 vjeçare. **Të rinjtë marrin pjesë tashmë në fazën e projektimit.** Në çdo emision ka një ekspert të temës, i cili jep informacione dhe shpjegime të vlefshme. Të rinjtë ftohen të ndajnë përvojat e tyre të kombinuara me informacione etike dhe të besueshme për tema të ndryshme. Ekipi i podkast-it (ekspertët, punonjësit e të rinjve dhe të rinjtë) sigurohen që të gjitha temat dhe shfaqjet të jenë jo-gjykuese, transparente dhe të përgjegjshme ndaj të rinjve.”

Kaie Pranno, Ekspert Kryesor @ Qendra e Punës Rinore Estoneze, Estoni

### DËSHMI

“U bashkova me ekipin editorial të The Sprout kur isha 17 vjeç. Isha plot pasion, por më pak i sigurt në vetvete. Gjatë 12 muajve në vijim, **u bëra redaktori tek TheSprout Music, dhe kam botuar me dhjetëra komente mbi muzikën live.** Një prej tyre tërhoqi vëmendjen e njëres prej gazetave më prestigjioze në Mbretërinë e Bashkuar, The Guardian, dhe kjo çoi në punësimin tim si reportere. Me besim të ripërtërirë tek vetja, u pranova në një kurs gazetarie në një universitet në Kanada”

Sofia (18 vjeç) – Kardif, Uells, Mbretëria e Bashkuar





## 7. ETIK

Shërbimet e informacionit për të rinjtë mbështeten nga një gamë e tërë e të drejtave të identifikuara në të drejtën ndërkombëtare (p.sh. Konventa e të Drejtave të Fëmijës, e vitit 1989). Në qendër të shërbimit është respekti për të riun.

- Ofron një mjedis të sigurt dhe konfidencial për të rinjtë, për të eksploruar dhe shprehur hapur nevojat, aspiratat dhe përvojat e tyre.
- Ofron një shërbim që respekton privatësinë dhe anonimitetin e të rinjve.
- Krijon një listë kontrolli të verifikueshmërisë dhe kriteret e transparencës për përzgjedhjen e informacionit.
- Është jogjykues, transparent dhe i përgjegjshëm ndaj të rinjve.
- U shpjegon të rinjve të drejtat dhe detyrimet e tyre si qytetarë.
- Është në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës dhe politikat publike.
- Kur nuk e dini, thoni se nuk dini dhe referojuni shërbimeve të tjera

### PRAKTIKË E MIRË

*"Sporteli me një ndalesë i informacionit për të rinjtë brenda Agenzjia Zghazagh, pranon një sërë referimesh pasi ai lidhet me shumë subjekte që punojnë me dhe për të rinjtë. Pas referimit, punonjësi i informacionit për të rinjtë ofron ndihmë të besueshme dhe të përshtatur sipas nevojave të të rinjve. **Ne ofrojmë mbështetje etike dhe të personalizuar dhe sigurohemi që informacioni i ndarë të mbrohet sipas politikave dhe procedurave të privatësisë të përcaktuara nga shërbimi gjegjës**".*

Sarah Spiteri, Zyrtare për Informimin e Rinisë @ Agenzija Zghazagh, Malta

### DËSHMI

*"Jam krenare të them se punonjësit në Qendrën e Informacionit Rinor luajtën një rol të madh që unë të ndihesha komod në Irlandë. Që nga dita e pare, **gjithmonë kam patur dikë me të cilin të mund të flisja për ndjenjat dhe problemet e mia të përditshme**".*

Lea (16) – Gjermani, au pair në Irlandë



## 8. PROFESIONALE

Shërbimet e informacionit për të rinjtë ofrohen nga personel i trajnuar, në mënyrë profesionale dhe me respekt. Sigurimi i cilësisë ka prioritet të lartë për të gjitha informacionet e prodhuara dhe të shpërndara.

- Përfshirja e planeve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve në strategjinë e shërbimit.
- Garantimi që ofruesit e informacionit për të rinjtë të kenë aftësi të avancuara të kuptimit të medias dhe informacionit.
- Zhvillimi i një sërë procedurash operacionale me në qendër të rinjtë.
- Garantimi që partneritetet kryesore strategjike të zhvillohen në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Puna në mënyrë të koordinuar dhe të rrjetëzuar me shërbimet dhe palët e tjera të interesit.

### PRAKTIKË E MIRË

*“Për faqen tonë të internetit të informacionit për të rinjtë [watwat.be](http://watwat.be) ne punojmë me më shumë se 70 ekspertë në më shumë se 100 tema. Çdo ekspert ka një hyrje personale në faqen e internetit. Pasi eksperti të ketë shkruar diçka në faqen e internetit, një redaktor nga De Ambrassade kontrollon nëse përmbajtja është e përshtatshme për të rinjtë apo jo. De Ambrassade bën komente për ekspertët. Në këtë mënyrë ekspertët mësojnë se si ta bëjnë përmbajtjen e tyre më miqësore për të rinjtë. Pas publikimit të përmbajtjes, eksperti mund të shohë gjithashtu se sa herë është lexuar artikulli i tij ose i saj dhe se si është vlerësuar përmbajtja”*

Marian Michielsens, Zyrtare e Informacionit për Rininë @ De Ambrassade, Belgjikë

### DËSHMI

*“Në kohën kur dëgjova për CIDJ, isha tërësisht i çorientuar. Nuk e dija vërtet se çfarë po bëja, as çfarë doja të bëja, dhe ata më ndihmuan të krijoja një horizont mundësisë. Thjesht, me mbështetjen dhe vëmendjen profesionale të tyre, munda të merrja vendimin më të mirë të jetës sime”.*

Jérôme (23) - Île-de-France, Francë



# 9. PROAKTIV

Ofruesit **proaktivë të informacionit për të rinjtë**, kërkojnë të jenë krijues, inovativë dhe të hapur për të eksperimentuar në mënyrën se si punojnë me të rinjtë.

- Zhvillon një strategji për të ndjekur trendet dhe për të kuptuar kulturën, prejardhjen dhe preferencat e të rinjve.
- Kërkon të përmirësojë vazhdimisht aftësitë dhe të fitojë kompetenca të reja.
- Njihet me mjetet inovative dixhitale dhe është një lojtar aktiv në peizazhin e ri mediatik.
- Garanton që shërbimet e informacionit për të rinjtë të jenë të dukshme dhe tërheqëse për të rinjtë.
- Monitoron dhe informon për ndryshimet përkatëse në legjislacion që prekin të rinjtë.
- Hartëzon hapësirat, mjediset dhe grupet e interesit për të rinjtë; dhe
- Bashkëpunon me palët e interesuara dhe ndërton partneritete të reja në nivele të ndryshme.

## PRAKTIKA E MIRË

*“Unë ndjek lajmet dhe bëj një monitorim aktiv në studimet dhe fushat e punës. Zbuloj edhe punë të reja duke shkuar të takoj atë që i krijon ose i zë. Marr pjesë në panele diskutimesh, punë bashkëpunuese dhe punëtori të praktikave të mira. E gjithë kjo për të këshilluar më mirë dhe për t’iu përgjigjur nevojave dhe pritshmërive të të rinjve. Unë përpiqem të siguroj që informacioni që u jap të rinjve të jetë i besueshëm dhe i përditësuar, në mënyrë që ata të marrin informacionin e duhur për të bërë zgjedhjen e tyre”.*

Valérie Deflandre, Këshilltar për Rininë @ CIDJ, Francë

## DËSHMI

*“Infomobil Tirol - MobilisierBar” është një ofertë argëtuese dhe interesante. Furgoni vjen në evente të ndryshme në të cilat marrim pjesë edhe unë me shokët e mi. Ai na shërben si një vend takimi dhe na jep informacione interesante. Kur je i ri, është e rëndësishme të dish për të drejtat e tua”*

Simon (17) – Tirol, Austri





European **youth information**  
and counselling agency

ERYICA a.s.b.l.  
[www.eryica.org](http://www.eryica.org)  
[secretariat@eryica.org](mailto:secretariat@eryica.org)



ISBN 978-2-919810-66-6



9 782919 810666